



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

KOMUNIKATË

21.10.2009

Në mbledhjen e 45-të me radhë Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar dhe miratuar një agjendë të gjërë të aktivitetesh dhe detyra, që lidhen me procesin zgjedhor. Anëtarët e KQZ-së, në fillim të mbledhjes kanë miratuar raportin e mbledhjes nr. 41/2009. Kryetarja e KQZ znj. Nesrin Lushta, ka paraqitur aktivitetet e saja para anëtarëve të KQZ-së. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, kryetarja Nesrin Lushta ka marrë pjesë më 30 tetor në takimin e organizuar nga Instituti Kosovar për Kërkime Politike dhe Zhvillim në Qendren Mediale në Çagllavicë. Pjesa e parë e takimit, është mbjatur me përfaqësues të mediave, kurse pjesa e dytë me përfaqësues të partive politike të komunitetit serb, lidhur me zgjedhjet e 15 nëntorit.

Më 1 tetor, kryetarja Lushta ka nënshkruar Marrëveshjen Teknike për Bashkpunim me IFES-in. Më 13 tetor, ka marrë pjesë në Konferencën e organizuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), lidhur me fushatën zgjedhore. Më 14 tetor, kryetarja Lushta është takuar me përfaqësues të Institutit Nacionaldemokratik (NDI) me seli në Prishtinë dhe, i ka informuar ata për përgatitjet e procesit zgjedhor. NDI ka publikuar një raport vlerësues për situatën parazgjedhore, të cilën e ka vlerësuar si mjaft të mirë. Po më 14 tetor, kryetarja Lushta ka marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Kodit të Mirësjelljes nga Partitë Politike që garojnë në zgjedhjet e 15 nëntorit, të cilën e ka organizuar Presidenti i Kosovës. Më 15 tetor, kryetarja Lushta është takuar me përfaqësuesit e ENEMO-s, të cilët kanë shprehur dëshirën për t'u akredituar për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 15 nëntorit. Dhe me 16 tetor, kryetarja Lushta ka marrë pjesë në mbledhjen me mbështetësit ndërkombëtar lidhur me zgjedhjet.

Kryeshefi i SKQZ-së, z. Xhemajl Peqani e ka informuar KQZ-në për takimin me përfaqësues ndërkombëtar, si dhe takimin me Komisionet Komunale Zgjedhore të komunave Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan. Gjithashtu, janë përfunduar trajnimet për trajnerë të Komisioneve të Vendvotimeve në Vushtrri, prej datës 17 deri më 20 tetor. Në javën e ardhshme, z. Peqani ka informuar për trajnimin e trajnerëve për të gjitha komunat. Qendra e Numrimit (QNR) është në përfundim të kompletimit. Një staf prej rreth 500 vetash, do të jetë gati së shpejti për të punuar në QNR. Gjithashtu prodhimi i Fletvotimeve në Slloveni po monitorohet nga KQZ dhe se fletvotimet për Asamblet Komunale janë prodhuar për 7 komuna, kurse fletvotimet për Kryetar të Komunave, janë prodhuar për 28 komuna.

Zyra për Reëgjistrimin e Partive Politike, e ka informuar KQZ-në për procesin e akreditimit deri më 19 tetor. ZRPP, i ka rekomanduar KQZ-së konform Rregulles 07/2009 që të bëjë akreditimin e 8 Subjekteve Politike, të 3 OJQ-ve, të 2 Organizatave Ndërkombëtare dhe të 3 Ambasadave. Kërkesat për akreditim, përfshijnë 6793 vëzhgues. KQZ, ka marrë vendim për akreditimin e këtyre vëzhguesëve.

Këshilli për Buxhet dhe Prokurim, ka informuar lidhur me shpenzimet e KQZ-së për muajin shtator. Kryesuesi i këtij këshilli z. Xhelil Pajaziti, ka paraqitur raportin sipas të cilit, gjatë muajit shtator janë shpenzuar 65.839.70 euro. KQZ e ka miratuar raportin e këtij këshilli.

Këshilli Mbikqyrës për Informim Publik, ka njoftuar KQZ-në lidhur me kërkesën e IFES-it (Fondacion Ndërkombëtar për Sistemet Elektorale), për ndryshime në sasinë e posterëve dhe të fletëpalosjeve. Z. Betim Gjoshi, ka njoftuar aktivitetet në këtë drejtim. KQZ e ka përkrahur kërkesën e IFES-it që të zvogëlohet numri i kopjeve për zgjedhjet në diasporë nga 50.000 sa ishin paraparë, në 3000 fletëpalosje. Të zvogëlohet numri i paraparë edhe për poster për Kryetar dhe Kuvende nga 59.000 në 30.00, ndërsa të rritet numri i kopjeve të fletëpalosjeve për Kryetar dhe Kuvende nga 76.000 në 114.000 (50% rritje).

Në vazhdim të mbledhjes, Këshilli për Operacione Zgjedhore, i ka rekërkuar KQZ-së që të shyrtojë zgjidhjet/ndryshimet në Zarfin e Fshehtësisë. Me vendim, KQZ ka parovuar kërkesat e këtij këshilli lidhur me Formularin e Rezultateve të Dengut (FRD). Gjithashtu, KQZ ka shqyrtuar kërkesën për paisje të anëtarëve të Këshillave të Vendotimeve me fotografi në Kartat e Identitetit (ID). KQZ ka aprovuar këtë kërkesë, duke rekomanduar që Komisionet Komunale Zgjedhore të udhëzohen në zbatimin e kësaj kërkesë. Në fund të mbledhjes, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka emëruar edhe anëtarët e Këshillave të Vendotimeve për komunën e Prishtinës.